



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3125/ 18 prot.

Datë 17/02/2026

V E N D I M
Nr. 268/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 17/02/2026, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 190/2026, datë 03.02.2026 për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-58215-08-15-2025 me objekt “Shërbimi i pastrimit të njësisë Orikum” me fond limit 27,910,435.00 (njëzet e shtatë milion e nëntëqind e dhjetë mijë e katërqind e tridhjetë e pesë) lekë pa TVSH ose 287,085.32 (dyqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e tetëdhjetë e pesë pikë tridhjetë e dy) euro pa TVSH, Kursi këmbimit 97.22 lekë, zhvilluar në datën 22.09.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë.

Ankimues: Operatori Ekonomik “Rej” SHPK, me NUIS J93711608Q, me adresë rruga “Dritan Hoxha”, Kulla Jeshile ngjitur me shkollën “Ahmet Gashi”, Nr. 8/374/ND+3-6, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Vlorë
Adresa: Sheshi “4 Heronjtë”, Rruga “Osman Haxhiu”, Vlorë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të

Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020
“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin
e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit
Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -
19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 03.02.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 190/2026, ku vendosi:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Rej” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-58215-08-15-2025 me objekt “Shërbimi i pastrimit të njësisë Orikum” me fond limit 27,910,435.00 (njëzet e shtatë milion e nëntëqind e dhjetë mijë e katërqind e tridhjetë e pesë) lekë pa TVSH ose 287,085.32 (dyqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e tetëdhjetë e pesë pikë tridhjetë e dy) euro pa TVSH, Kursi këmbimit 97.22 lekë, zhvilluar në datën 22.09.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO mbi kualifikimin e operatorëve ekonomikë “Korsel” SHPK dhe “Pastrime Silvio” SHPK, si dhe të korrigjojë shkeljet duke i skualifikuar ato.
3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Rej” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi, i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 2569/1 prot, datë 09.02.2026, me objekt “Vënie në dijeni lidhur me zbatimin e vendimit me nr. 190/2026” protokolluar me tonën me nr. 3125/15 prot, datë 12.02.2026, autoriteti kontraktor Bashkia Vlorë, ka informuar Komisionin e Prokurimit Publik mbi zbatimin e vendimit KPP 190/2026, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-58215-08-15-2025 me objekt “Shërbimi i pastrimit të njësisë Orikum” me fond limit 27,910,435.00 (njëzet e shtatë milion e nëntëqind e dhjetë mijë e katërqind e tridhjetë e pesë) lekë pa TVSH ose 287,085.32 (dyqind e tetëdhjetë e shtatë mijë

e tetëdhjetë e pesë pikë tridhjetë e dy) euro pa TVSH, Kursi këmbimit 97.22 lekë, zhvilluar në datën 22.09.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr. 2569/1 prot, datë 09.02.2026, me objekt “Vënie në dijeni lidhur me zbatimin e vendimit me nr. 190/2026” protokolluar me tonën me nr. 3125/15 prot, datë 12.02.2026, autoriteti kontraktor Bashkia Vlorë, ka informuar Komisionin e Prokurimit Publik mbi zbatimin e vendimit KPP 190/2026, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-58215-08-15-2025 me objekt “*Shërbimi i pastrimit të njësisë Orikum*” me fond limit 27,910,435.00 (njëzet e shtatë milion e nëntëqind e dhjetë mijë e katërqind e tridhjetë e pesë) lekë pa TVSH ose 287,085.32 (dyqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e tetëdhjetë e pesë pikë tridhjetë e dy) euro pa TVSH, Kursi këmbimit 97.22 lekë, zhvilluar në datën 22.09.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë.

Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, Komisioni vëren se, autoriteti kontraktor nëpërmjetë shkresës së mësipërcituar ka dërguar pranë Komisionit Prokurimit Publik praktikën për zbatimin e vendimit nr. 190/2026 datë 03.02.2026, të KPP. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik dhe raport auditit KPP konstaton se autoriteti kontraktor ka kryer rivlersimin e procedurës në zbatim të përcaktimeve të bëra në vendimin KPP 190/2026, datë 03.02.2026 për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “*Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-58215-08-15-2025 me objekt “*Shërbimi i pastrimit të njësisë Orikum*” me fond limit 27,910,435.00 (njëzet e shtatë milion e nëntëqind e dhjetë mijë e katërqind e tridhjetë e

pesë) lekë pa TVSH ose 287,085.32 (dyqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e tetëdhjetë e pesë pikë tridhjetë e dy) euro pa TVSH, Kursi këmbimit 97.22 lekë, zhvilluar në datën 22.09.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë.

2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

